



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Buletini i Njoftimeve Publike

Nr.100

Datë 11.12.2023

Agjencia e Prokurimit Publik

Blv "Dëshmorët e Kombit"

Tel: + 355 4 2277510

e-mail: info.app@app.gov.al

<https://www.app.gov.al>



UNIVERISITETI “EQREM ÇABEJ”

Njoftim për vend të lirë pune

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 57 dhe 66; Statutit të Universitetit “Eqrem Çabej”, nenet 47, 52, 54, shpall konkursin për personel akademik dhe ndihmës akademik, si më poshtë:

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510

<https://www.app.gov.al> 573/582

Buletini Nr. 100 datë 11 Dhjetor 2023

Agjencia e Prokurimit Publik

1. I(një) personel ndihmës akademik me angazhim me kohë të plotë, pranë Drejtorisë së Shqrbimeve Ndhmësakademike Administrative, Sektori i Standarteve dhe Korrikulave.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

- të kenë mbaruar studimet universitare në sistemin me kohë të plotë, brenda ose jashtë vendit;
- për të interesuarit zotërojnë një diplomë të lëshuar nga një universitet jashtë vendit, kërkohet njehësimi i saj pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve;
- të kenë kualifikime të dëshmuara dhe eksperiencia në fushën e arsimit parauniversitar dhe universitar;
- të zotërojnë aftësi për përpunimin e shpejtë në kohë të dokumentacionit mësimor; komunikim perfekt me autoritetet, organet, strukturat dhe personelin e institucionit; me një format të zhvilluar në fushën organizative, të etikës dhe të punës në grup;
- të zotërojnë kompetenca kompjuterike që mundësojnë një përpunim të shpejtë në kohë të dokumentacionit mësimor;
- të kenë punuar si mësues/specialistë në institucione publike dhe/ose private, me preferencë ata/ato që kanë patur për objekt hartimin, përpunimin dhe prezantimin të dokumentacionit mësimor;
- të zotërojnë aftësinë e raportimit në kohë të detyrave të ngarkuara.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët që konkurojnë

1. Kërkesë me shkrim;
2. Jetëshkrim sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
4. Kopje të diplomës dhe të listës së notave përkatëse (të noteruara). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të dorëzohet njehësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (Raport mjekësor për aftësitë në punë);
7. Vërtetim i gjëndjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
8. Dokumentacion nga institucioni ku ka punuar që nuk është marrë ndaj tyre masa disiplinore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera në jetëshkrim;
10. Dëshmi penaliteti.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën. Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell s'kualifikim të kandidatit. Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nga komisioni ad-hoc nëpërmjet konkurimit me dosje. Konkursi zhvillohet pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Dokumentat, të noterizuara brenda tre muajve të fundit, dorëzohen pranë Drejtorisë së Shqrbimeve Ndhmësakademike Administrative në Universitetin “Eqrem Çabej”.

Afati i fundit i pritjes së aplikimeve është brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit.